FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr. 28	2002	Qershor

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Ligj nr.8904, datë 6.6.2002	Për disa ndryshime në ligjin nr.7665, datë 21.1.1993 "Për zhvillimin e zonave që kanë përparësi turizmin" me ndryshimet përkatëse……	881
Vendim i Kuvendit nr. 45, datë 13.6.2002	Për miratimin e dekretit të Presidentit nr.3063, datë 18.6.2001 "Për kthimin për rishqyrtim të ligjit nr.8813, datë 17.5.2001 "Për disa shtesa e ndryshime në ligjin nr.7905, datë 21.3.1995 "Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë" ……..	882
Vendim i Kuvendit nr. 46, datë 13.6.2002	Për një shtesë në Rregulloren e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, miratuar me vendimin e Kuvendit nr.357, datë 9.4.1998, ndryshuar me vendimin nr.399, datë 4.2.1999 dhe me vendimin nr.31, datë 2.5.2002……..	882
Udhëzim i KQZ nr. 4, datë 18.6.2002	Për detyrat e policisë së shtetit në fushatën zgjedhore për zgjedhjet e pjesshme në zonën zgjedhore nr.19 për deputetë të drejtpërdrejtë për Kuvendin e Shqipërisë të datës 7.7.2002.	888
Udhëzim i KQZ	Për prodhimin, shpërndarjen dhe përdorimin e	889

nr. 5, datë 18.6.2002	fletëvotimeve nga KQV-të e zonës zgjedhore nr.19 për zgjedhjet e pjesshme për deputetë të drejtpërdrejtë për Kuvendin e Shqipërisë të datës 7.7.2002……	
Udhëzim i KQZ nr. 6, datë 18.6.2002	Për plotësimin dhe shpërndarjen e tabelave të rezultateve në qendrat e votimit për zgjedhjet e pjesshme për deputet të drejtpërdrejtë në zonën zgjedhore nr.19 për Kuvendin e Shqipërisë të datës 7.7.2002……..	889
Udhëzim i KQZ nr. 7, datë 18.6.2002	Për vendosjen e kopjeve origjinale të tabelave, procesverbaleve dhe vulës së KQV-ve në kutinë e votimit që përmban fletëvotimet për deputet në zonën njëemërore…….	890
	Vendim (i shkurtuar) për heqjen e zotësisë të shtetasit Halit Plasa……	891
	Vendim për heqjen e zotësisë për të vepruar të shtetasit Anteos Vasil Zhongo……..	891
	K*ërkesë* për shpallje të zhdukur të shtetasit Liman Spahiu	891
	Kërkesë për shpallje të zhdukur të Petrit Aliaj……..	891

L I G J
Nr. 8904, datë 6.6.2002

PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.7665, DATË 21.1.1993 "PËR ZHVILLIMIN E ZONAVE QË KANË PËRPARËSI TURIZMIN" ME NDRYSHIMET PËRKATËSE

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

Në ligjin nr.7665, datë 21.1.1993 "Për zhvillimin e zonave që kanë përparësi turizmin" me ndryshimet përkatëse, bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Në nenin 4:
1. Paragrafi i parë dhe i tretë shfuqizohen.
2. Paragrafi i dytë ndryshohet si më poshtë:
"Krijohet Këshilli i Zhvillimit të Turizmit, si organ ndërministror. Përbërja, funksionet, detyrat, përgjegjësitë dhe organizimi i brendshëm miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.".

Neni 2

Në të gjitha nenet e ligjit nr.7665, datë 21.1.1993 "Për zhvillimin e zonave që kanë përparësi turizmin" me ndryshimet përkatëse, bëhen këto zëvendësime:
1. Fjalët "Komiteti për Zhvillimin e Turizmit" zëvendësohen me fjalët "Ministria e Rregullimit të Territorit dhe Turizmit".
2. Fjalët "Këshilli i Politikave të Zhvillimit të Turizmit" zëvendësohen me fjalët "Këshilli i Zhvillimit të Turizmit".
3. Fjalët "Kryetari i Komitetit të Zhvillimit të Turizmit" zëvendësohen me fjalët "Ministri i Rregullimit të Territorit dhe Turizmit".

Neni 3

Çdo akt ligjor dhe nënligjor që bie në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji shfuqizohet.

Neni 4

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr. 3378, datë 24.6.2002 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani

V E N D I M
Nr. 45, datë 13.6.2002

PËR MIRATIMIN E DEKRETIT TË PRESIDENTIT NR.3063, DATË 18.6.2001 "PËR KTHIMIN PËR RISHQYRTIM TË LIGJIT NR.8813, DATË 17.5.2001 "PËR DISA SHTESA E NDRYSHIME NË LIGJIN NR.7905, DATË 21.3.1995 "KODI I PROCEDURËS PENALE I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË"

Në mbështetje të nenit 85 të Kushtetutës dhe të nenit 88 të Rregullores së Kuvendit,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

I. Miratohet dekreti i Presidentit nr.3063, datë 18.6.2001 "Për kthimin për rishqyrtim të ligjit nr.8813, datë 17.5.2001 "Për disa shtesa e ndryshime në ligjin nr.7905, datë 21.3.1995 "Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë"".

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Servet Pëllumbi

V E N D I M
Nr. 46, datë 13.6.2002

PËR NJË SHTESË NË RREGULLOREN E KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, MIRATUAR ME VENDIMIN E KUVENDIT NR.357, DATË 9.4.1998, NDRYSHUAR ME VENDIMIN NR.399, DATË 4.2.1999 DHE ME VENDIMIN NR.31, DATË 2.5.2002

Në mbështetje të nenit 75 pika 2 të Kushtetutës dhe 172 të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, me propozimin e Kryetarit të Kuvendit,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

I. Miratohet pjesa shtesë III/a në Rregulloren e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë me titull "Procedura për zgjedhjen e Presidentit të Republikës", sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Servet Pëllumbi

PJESA III/A
PROCEDURA PËR ZGJEDHJEN E PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS

I. Fillimi i procedurës për zgjedhjen e Presidentit

Neni 169/1

Zgjedhja e Presidentit të Republikës bëhet në përputhje me kërkesat e neneve 86, 87, 88 pika 2 dhe 91 të Kushtetutës.

Neni 169/2

Kryetari i Kuvendit, jo më vonë se 14 ditë nga afati i përcaktuar në nenin 88 pika 2 të Kushtetutës, inicion fillimin e procedurës për zgjedhjen e Presidentit dhe thërret në mbledhje të veçantë Byronë e Kuvendit.

Neni 169/3

Kryetari i Kuvendit bën regjistrimin e kandidatëve për President, sipas procedurave administrative të funksionimit të Kuvendit.

Ai ngarkon Komisionin e Përhershëm për Çështjet Kushtetuese dhe Ligjore të bëjë verifikimin e kritereve ligjore për plotësimin e dokumentacionit për kandidatët për President.

Më pas ky dokumentacion i bëhet i njohur Byrosë Parlamentare dhe seancës plenare.

Neni 169/4

Kur ka ankime për interpretimin kushtetues të procedurave për zgjedhjen e Presidentit, parregullsi në dokumentacionin dhe vlefshmërinë e regjistrimit të kandidatit për President, ankimi u paraqitet dy komisioneve: Komisionit të Përhershëm për Çështjet Kushtetuese dhe Ligjore dhe Komisionit të Përhershëm të Mandateve, Imunitetit dhe Rregullores.

Këto komisione, në mbledhje të përbashkët, marrin në shqyrtim ankesën brenda ditës dhe relacionin me vendimin përkatës ia përcjellin seancës plenare.

II. Regjistrimi i kandidatëve për President

Neni 169/5

Kandidati për President i propozohet Kuvendit në përputhje me nenin 87 pika 1 të Kushtetutës.

Dokumentet për regjistrimin e kandidatit për President duhet të jenë në përputhje me nenin 86 pika 2 të Kushtetutës dhe duhet të përmbajnë:

a) listën e deputetëve propozues me firmat përkatëse;

b) curriculum vitae të kandidatit për President;

c) deklaratën e kandidatit që shpreh vullnetin e tij për të kandiduar.

Neni 169/6

Dokumentet për regjistrimin e kandidatit paraqiten te Kryetari i Kuvendit jo më vonë se 24 orë përpara orës së caktuar të votimit të radhës.

Neni 169/7

Në rast se konstatohet se dokumentet nuk janë të plota, u kërkohet propozuesve të bëjnë plotësimet përkatëse. Plotësimi i dokumenteve pas afatit të përcaktuar më sipër nuk përjashton regjistrimin e kandidatit, por në çdo rast ky plotësim duhet të bëhet jo më vonë se 4 orë nga ora e caktuar për votim.

Neni 169/8

Në rast se një kandidat për President jep dorëheqjen para ditës së votimit, grupi i deputetëve propozues ka të drejtë ta zëvendësojë, por jo më vonë se 5 orë përpara fillimit të votimit.

Në votimin e katërt dhe të pestë nuk mund të bëhet zëvendësimi nga grupi i deputetëve propozues në rast se kandidati jep dorëheqjen.

III. Procedura e votimit

Neni 169/9

Kryetari i Kuvendit, në ditën e votimit, hap seancën plenare dhe i paraqet Kuvendit listën e regjistrimit të kandidatëve për President, si dhe propozon fillimin e procedurës së votimit me zgjedhjen e Komisionit të Votimit.

Komisioni i Votimit përbëhet nga jo më shumë se 7 deputetë. Përbërja e tij caktohet sipas raporteve të përfaqësimit politik në Kuvend.

Komisioni, në mbledhjen e tij të parë, zgjedh Kryetarin, Zëvendëskryetarin dhe Sekretarin e tij.

Neni 169/10

Për zgjedhjen e Presidentit të Republikës do të ndiqen këto procedura votimi nga Komisioni i Votimit:

a) votimi për zgjedhjen e Presidentit bëhet i fshehtë;

b) votimi bëhet me fletëvotimi;

c) në fletën e votimit kandidatët për President regjistrohen sipas rendit alfabetik;

ç) Kryetari i Komisionit merr në dorëzim listën e deputetëve që do të votojnë;

d) Komisioni përgatit dhomat e fshehta të votimit;

dh) votimi bëhet duke thirrur sipas listës alfabetike emrat e deputetëve. Në përfundim të listës, Kryetari bën edhe një herë thirrjen e deputetëve që nuk janë paraqitur;

e) fleta e votimit është e sekretuar;

ë) fleta e votimit firmoset para shpërndarjes nga Kryetari, Zëvendëskryetari dhe Sekretari i Komisionit;

f) fleta e votimit do të ketë emrat e kandidatëve dhe përbri një kuadrat ku do të vendoset shenja, sipas përcaktimit në shkronjën "gj";

g) votimi do të bëhet nga të gjithë deputetët vetëm me një lloj stilolapsi;

gj) shenja e votimit është një "iks" X ose "plus" + në kuadratin e caktuar përbri emrit të kandidatit;

h) në përfundim të votimit, Kryetari i Komisionit shpall mbylljen e tij dhe urdhëron hapjen e kutisë së votimit;

i) kutia e votimit hapet në prani të Komisionit dhe të deputetëve në seancë plenare;

j) Kryetari i Komisionit lexon publikisht çdo fletë votimi;

k) pas leximit të të gjitha fletëve të votimit, Komisioni nxjerr rezultatin përfundimtar, të cilin e shpall në seancë Kryetari i Komisionit të Votimit duke lexuar numrin e fletëve të votimit të hedhura në kuti, numrin e votave të marra nga çdo kandidat dhe numrin e votave të pavlefshme;

l) në përfundim plotësohet procesverbali përkatës, i cili firmoset nga të gjithë anëtarët e Komisionit dhe ai është i vlefshëm kur e nënshkruajnë më shumë se gjysma e anëtarëve;

ll) fleta e votimit është e pavlefshme dhe nuk llogaritet për asnjë kandidat kur:

i) ka më shumë se një shenjë;

ii) nuk ka asnjë shenjë;

iii) ka shënime të tjera që nuk lënë të kuptohet qartë vullneti i zgjedhësit;

iv) fleta e votimit është e parregullt (e grisur dhe pa shenjat e sekretimit të caktuar).

Neni 169/11

Çdo deputet ka të drejtë të bëjë ankesë me shkrim lidhur me pretendimet e tij për shkeljen e procedurave të votimit.

Komisioni e shqyrton menjëherë ankesën dhe merr një vendim që i komunikohet seancës. Në rast se konstatohet se ka shkelje thelbësore të procedurës së votimit, Komisioni i Votimit me shumicë votash vendos përsëritjen e procesit të votimit.

IV. Regjistrimi dhe prezantimi i kandidatëve për votimin e parë
dhe zhvillimi i votimit

Neni 169/12

Kryetari i Kuvendit, pasi konsultohet me kryetarët e grupeve parlamentare, vendos ditën dhe orën e votimit të parë në Kuvend për zgjedhjen e Presidentit të Republikës. Kryetari i Kuvendit zhvillon seancën në përputhje me nenet 90 dhe 104 të Rregullores së Kuvendit.

Neni 169/13

Regjistrimi i kandidatëve për President për votimin e parë bëhet, sipas neneve 169/5-169/8 të kësaj pjese të Rregullores.

Neni 169/14

Pas zhvillimit të votimit të parë, kandidati për President që ka marrë një shumicë prej tri të pestave të të gjithë anëtarëve të Kuvendit shpallet President i Republikës.

Neni 169/15

Në rast se asnjë nga kandidatët për President nuk ka marrë shumicën e kërkuar të votave zhvillohet një votim i dytë, sipas së njëjtës procedurë të ndjekur në votimin e parë, shprehur në nenet 169/5-169/8 dhe 169/10 të kësaj pjese të Rregullores.

Neni 169/16

Kryetari i Kuvendit pas deklarimit të rezultateve të votimit të parë, vendos për ditën dhe orën e zhvillimit të votimit të dytë, pasi të jetë konsultuar me kryetarët e grupeve parlamentare. Kryetari i Kuvendit zhvillon seancën në përputhje me nenet 90 dhe 104 të Rregullores së Kuvendit.

V. Regjistrimi dhe prezantimi i kandidatëve për votimin e dytë
dhe zhvillimi i votimit

Neni 169/17

Për votimin e dytë mund të regjistrohen sipas neneve 169/5-169/8 të kësaj pjese të Rregullores kandidatë të rinj nga një numër jo më pak se 20 deputetë, që nuk kanë marrë pjesë në asnjë grup propozues në votimin e parë, ose kur kandidati që ata propozonin në votimin e parë është tërhequr.

Neni 169/18

Pas zhvillimit të votimit të dytë, kandidati për President që ka marrë një shumicë prej tri të pestave të të gjithë anëtarëve të Kuvendit shpallet President i Republikës.

Neni 169/19

Në rast se asnjë nga kandidatët për President nuk ka marrë shumicën e kërkuar të votave, zhvillohet një votim i tretë.

Neni 169/20

Kryetari i Kuvendit, pas deklarimit të rezultateve të votimit të dytë, vendos për ditën dhe orën e zhvillimit të votimit të tretë, pasi të jetë konsultuar me kryetarët e grupeve parlamentare. Kryetari i Kuvendit zhvillon seancën në përputhje me nenet 90 dhe 104 të Rregullores së Kuvendit.

VI. Regjistrimi dhe prezantimi i kandidatëve për votimin e tretë dhe zhvillimi i votimit

Neni 169/21

Për votimin e tretë mund të regjistrohen sipas neneve 169/5-169/8 të kësaj pjese të Rregullores kandidatë të rinj nga një numër jo më pak se 20 deputetë që nuk kanë marrë pjesë në asnjë grup propozues në votimin e parë dhe të dytë, ose kur kandidati që ata propozonin në votimin e dytë është tërhequr.

Neni 169/22

Pas zhvillimit të votimit të tretë, kandidati për President që ka marrë një shumicë prej tri të pestave të të gjithë anëtarëve të Kuvendit, shpallet President i Republikës.

Neni 169/23

Në rast se në votimin e tretë ka më shumë se dy kandidatë dhe asnjë prej tyre nuk ka fituar shumicën e votave, votimi i katërt bëhet ndërmjet dy kandidatëve që kanë marrë numrin më të madh të votave në votimin e tretë.

Në rast se asnjë nga kandidatët për President nuk ka marrë shumicën e kërkuar të votave zhvillohet një votim i katërt.

Neni 169/24

Kryetari i Kuvendit, pas deklarimit të rezultateve të votimit të tretë, vendos për ditën dhe orën e zhvillimit të votimit të katërt, pasi të jetë konsultuar me kryetarët e grupeve parlamentare. Kryetari i Kuvendit zhvillon seancën në përputhje me nenet 90 dhe 104 të Rregullores së Kuvendit.

VII. Votimi i katërt

Neni 169/25

Komisioni për zgjedhjen e Presidentit përgatit fletët e votimit me emrat e dy kandidatëve që plotësojnë kushtin e parashikuar në nenin 169/23 të kësaj pjese të Rregullores.

Neni 169/26

Në rast se dy kandidatë kanë marrë numër të njëjtë votash në votimin e tretë dhe për nga numri plotësojnë kushtin për të vazhduar në votimin e katërt me një kandidat që ka marrë më shumë vota, kandidati që do të vazhdojë në votimin e katërt vendoset me short. Procedura për hedhjen e shortit zhvillohet nga Komisioni.

Neni 169/27

Pas zhvillimit të votimit të katërt, kandidati për President që ka marrë një shumicë prej tri të pestave të të gjithë anëtarëve të Kuvendit, shpallet President i Republikës.

Neni 169/28

Në rast se asnjë nga kandidatët për President nuk ka marrë shumicën e kërkuar të votave, zhvillohet një votim i pestë.

Neni 169/29

Kryetari i Kuvendit, pas deklarimit të rezultateve të votimit të katërt, vendos për datën dhe orën e zhvillimit të votimit të pestë, pasi të jetë konsultuar me kryetarët e grupeve parlamentare, e cila nuk mund të jetë më vonë se 10 ditë nga votimi i katërt. Kryetari i Kuvendit zhvillon seancën në

përputhje me nenet 90 dhe 104 të Rregullores së Kuvendit.

VIII. Votimi i pestë

Neni 169/30

Votimi i pestë bëhet ndërmjet dy kandidatëve që kanë marrë pjesë në votimin e katërt dhe asnjëri nuk ka marrë shumicën e kërkuar të votave.

Neni 169/31

Pas zhvillimit të votimit të pestë, kandidati për President që ka marrë një shumicë prej tri të pestave të të gjithë anëtarëve të Kuvendit, shpallet President i Republikës.

Kryetari i Kuvendit, në këtë rast, rikonfirmon zyrtarisht në seancë Presidentin e ri dhe cakton ditën e betimit në Kuvend.

IX. Shpërndarja e Kuvendit

Neni 169/32

Në rast se Kuvendi, pas votimit të pestë, nuk arrin të zgjedhë Presidentin e Republikës, Kryetari i Kuvendit shpall shpërndarjen e tij, sipas nenit 87 pika 8 të Kushtetutës.

U D H Ë Z I M
Nr. 4, datë 18.6.2002

PËR DETYRAT E POLICISË SË SHTETIT NË FUSHATËN ZGJEDHORE PËR ZGJEDHJET E PJESSHME NË ZONËN ZGJEDHORE NR.19 PËR DEPUTETË TË DREJTPËRDREJTË PËR KUVENDIN E SHQIPËRISË TË DATËS 7.7.2002.

Në mbështetje të nenit 18 të ligjit nr.8609, datë 8.5.2000 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

U D H Ë Z O N:

Me qëllim garantimin e ecurisë normale të procesit zgjedhor, organet e policisë së shtetit në raport me nivelet e ndryshme të komisioneve kanë këto detyra:

1. Shoqërimin me polic të mjeteve që do të transportojnë fletëvotimet nga magazina e KQZ-së deri në prefekturë dhe në KZZ-në nr.19, kundrejt kërkesës dhe planit të lëvizjes së mjeteve të miratuar nga KQZ-ja.

2. Organizimi i ruajtjes së ambienteve të punës së KZZ-së nr.19 gjatë periudhës zgjedhore, deri në dorëzimin në KQZ të tabelave të rezultateve dhe kutive të votimit nga KZZ-ja nr.19.

3. Organizimi i ruajtjes së qendrave të votimit të zonës zgjedhore nr.19 nga ora 12.00 e datës 6.7.2002 e në vijim, të vazhdojë deri në përfundimin e votimit, nxjerrjen e rezultateve dhe shoqërimin e përfaqësuesve të KQV-së për dorëzimin e tabelave të rezultateve dhe kutive të votimit në KZZ-në nr.19.

Për organizimin dhe realizimin e kësaj detyre KZZ-ja nr.19, i jep drejtorit të policisë në prefekturë një kopje të vendimit të KZZ-së nr.19 "Për caktimin vendndodhjes së qendrave të votimit" model 29.

4. Policët e caktuar me shërbim në qendrat e votimit, në mbrëmjen e datës 6.7.2002, të jenë prezent së bashku me anëtarët e KQV-së në momentin e mbylljes me çelës dhe dyllosjes së derës së qendrës së votimit. Në orën 7.00 të datës 7.7.2002, në prezencën të komisionit, asistojnë në hapjen e qendrës së votimit dhe nga ky moment deri në përfundimin e procesit, të ruajnë objektin në fjalë në

distancë deri 100 m.

5. Nëse gjatë procesit të votimit rrezikohet rendi dhe zhvillimi i rregullt i votimit, kur cenohet rendi, kur shfaqen shenja dhune ndaj zgjedhësve apo anëtarëve të komisionit, kur pengohen procedurat e votimit dhe zgjidhja e konfliktit nuk mund të bëhet me mirëkuptim, KQV-ja vendos pezullimin e votimit dhe kryetari e zëvendëskryetari apo secili prej tyre kërkon ndihmën e policisë, duke njoftuar menjëherë edhe KZZ-në nr.19 për incidentin e ndodhur.

Me kërkesën e kryetarit dhe zëvendëskryetarit të KQV-së apo të secilit prej tyre, policët vihen në shërbim të Komisionit të Qendrës së Votimit, deri në evitimin e parregullsisë së vërejtur. Me rivendosjen e rendit, policëve u kërkohet të largohen nga qendra e votimit për të vazhduar ruajtjen në distancë të saj, ndërkohë KQV-ja merr masa për vazhdimin e procesit të votimit.

Me rivendosjen e rendit dhe rifillimin e votimit , KQV-ja informon KZZ-në nr.19.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

U D H Ë Z I M
Nr. 5, datë 18.6.2002

PËR PRODHIMIN, SHPËRNDARJEN DHE PËRDORIMIN E FLETËVOTIMEVE NGA KQV-TË E ZONËS ZGJEDHORE NR.19 PËR ZGJEDHJET E PJESSHME PËR DEPUTETË TË DREJTPËRDREJTË PËR KUVENDIN E SHQIPËRISË TË DATËS 7.7.2002

Në mbështetje të nenit 89 të ligjit nr.8609, datë 8.5.2000 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

U D H Ë Z O N:

1. Për zgjedhjet e pjesshme të datës 7.7.2002 për deputetë të drejtpëdrejtë në zonën zgjedhore nr.19 për Kuvendin e Shqipërisë, fletëvotimeve për këtë zonë të prodhohen në masën 2% mbi numrin e përgjithshëm të votuesve në listat përfundimtare të zgjedhësve.

2. Shpërndarja e fletëvotimeve nga KZZ-ja nr.19 në çdo KQV të bëhet si vijon:

a) Pjestohet numri i fletëvotimeve që i janë dhënë KZZ-së nr.19 nga KQZ-ja, me numrin e votuesve të listës përfundimtare të zgjedhësve të kësaj zone dhe rezultati i pjestimit shumëzohet me numrin e votuesve të listës përfundimtare të qendrës nr.1 të votimit. Rezultati që del nga shumëzimi është numri i fletëvotimit që KZZ-ja nr.19 duhet t'i japë KQV-së përkatëse. Me të njëjtën procedurë përcaktohet edhe numri i fletëvotimeve për qendrat e tjera të votimit të zonës zgjedhore nr.19.

b) KZZ-ja nr.19 nuk mban asnjë fletëvotimi gjendje (rezervë).

3. Për përdorimin e fletëvotimeve komisionet e qendrave të votimit veprojnë si vijon:

Në fillim të çeljes së votimeve kryetari dhe zëvendëskryetari firmosin deri 50 copë fletë votimi, të cilat vulosen nga sekretari i KQV-së një nga një në momentin që i jepen votuesit. Më tej, firmosja e fletëvotimeve do të shkojë paralel me intensitetin e paraqitjes së votuesve dhe në total në fund të procesit të votimit duhet të jenë firmosur, vulosur dhe përdorur aq fletëvotimi sa votues kanë marrë pjesë në votim.

Fletëvotimet e papërdorura nuk duhet të kenë firma e vulë.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

U D H Ë Z I M
Nr. 6, datë 18.6.2002

PËR PLOTËSIMIN DHE SHPËRNDARJEN E TABELAVE TË REZULTATEVE NË QENDRAT E VOTIMIT PËR ZGJEDHJET E PJESSHME PËR DEPUTETË TË DREJTPËRDREJTË NË ZONËN ZGJEDHORE NR.19 PËR KUVENDIN E SHQIPËRISË TË DATËS 7.7.2002

Në mbështetje të nenit 106 dhe 107 të ligjit nr.8609, datë 8.5.2000 "Kodi Zgjedhor i

Republikës së Shqipërisë", Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

U D H Ë Z O N:

1. Tabelat e rezultateve model 54, 65 plotësohen nga KQV-ja, sipas procedurës së përcaktuar në nenin 106 të ligjit nr.8609, datë 8.5.2000 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë" manualin e këtyre komisioneve dhe shënimet udhëzuese të çdo tabele.

2. Me qëllim shmangien e konfuzionit në KQV dhe zhvillimin e procedurave të sakta dhe të shpejta, rekomandohet që, si rregull, anëtarëve të KQV-së, përfaqësuesve të subjekteve politike, apo kandidatëve, si dhe vëzhguesve vendas dhe të huaj që dëshirojnë të marrin një kopje të tabelave të rezultateve t'u jepet modeli 56 "Tabela e përgjithshme rezultateve".

3. Në raste kur një anëtar i KQV-së, përfaqësues i një subjekti zgjedhor apo një vëzhgues ka kundërshtuar rezultatin e pasqyruar në tabelën model 54 dhe, për kundërshtimin, KQV-ja ka marrë një vendim të cilin ankuesi vazhdon ta kundërshtojë, në këtë rast apo në raste të ngjashme, kërkuesit i jepet një kopje e tabelës model 54.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

U D H Ë Z I M
Nr. 7, datë 18.6.2002

PËR VENDOSJEN E KOPJEVE ORIGJINALE TË TABELAVE, PROCESVERBALEVE DHE VULËS SË KQV-SË NË KUTINË E VOTIMIT QË PËRMBAN FLETËVOTIMET PËR DEPUTET NË ZONËN NJËEMËRORE

Në bazë të nenit 106 pika 6 e ligjit 8609, datë 8.5.2002 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

U D H Ë Z O N:

1. KQV-ja pas numërimit të fletëvotimeve për deputetë të drejtpërdrejtë në zonën njëemërore, zarfet me fletëvotimet e përdorura dhe të papërdorura i fut në kutinë e votimit. Mbi bazën e fletëvotimeve të përdorura plotësohet "Tabela e rezultateve të qendrës së votimit nr._____, për deputet të drejtpëdrejtë në zonën zgjedhore nr.19" (modeli 54).

2. Pas plotësimit të tabelës model 54, kryetari i KQV-së plotëson "Tabelën e përgjithshme të rezultateve të qendrës së votimit Nr._____ të zonës zgjedhore nr.19", modeli 56, e cila përmbledh të dhënat e tabelës së mësipërme, model 54.

3. Kopjet origjinale të dy tabelave (modelet 54 dhe 56), si dhe procesverbalet dhe vula e KQV-së vendosen në kutinë e votimit. Një kopje tjetër origjinale e tabelave model 54 dhe 56 e plotësuar, vendosen në një zarf të veçantë.

4. Kutia e votimit vuloset me vulat jeshile dhe numrat identifikues të vulave regjistrohen në fletoren e procesverbalit të KQV-së.

5. Kryetari, Zëvendëskryetari dhe Sekretari i KQV-ve të zonës zgjedhore nr.19 i dorëzojnë KZZ-së nr.19, brenda 24 orëve nga mbyllja e votimit, kutinë e votimit dhe zarfin me tabelat e rezultateve të votimit.

KZZ-ja i lëshon kryetarit të KQV-së një procesverbal dorëzimi, sipas modelit të miratuar nga KQZ-ja.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETARI
Sokol Shazi

V E N D I M
(I SHKURTUAR)

Gjykata e Shkallës së Parë të Rrethit Gjyqësor Korçë, vendos heqjen e zotësisë për të vepruar të shtetasit Halit Plasa, lindur më 1961, dhe vënien e tij në kujdestari të përkohshme të motrës së tij Satber Shule.

V E N D I M

Sipas kërkesës së bërë nga Vasil Zhongo, i biri i Fotos, lindur më 1949 dhe banues në Vanistër të Gjirokastrës, Gjykata e Shkallës së Parë të Rrethit Gjirokastër vendosi heqjen e zotësisë për të vepruar shtetasit Anteos Vasil Zhongo dhe caktimin si kujdestar të përkohshëm të tij Vasil Zhongon.

K Ë R K E S Ë

Kërkuese: Behare Aliaj, e bija e Shaqes dhe e Tekiut, lindur më 1955 në Corush të Mallakastrës, banuese në Vlorë.

Objekti: Kërkoj të shpallet i zhdukur bashkëshorti Petrit Aliaj.

Në tetor të vitit 1993 bashkëshorti im është larguar për punë me anijen "Joni". Në rethana të paditura anija mbytet dhe prej kësaj dite nuk kemi asnjë të dhënë për fatin e tij, prandaj kërkoj të shpallet i zhdukur bashkëshorti im Petrit Aliaj.

KËRKUESE
Behare Aliaj

K Ë R K E S Ë

Kërkues: Luiza Rula e bija e Nikollës dhe e Antigonit, lindur më 1949 në Korçë.

Objekti: Kërkoj të shpallet i zhdukur bashkëshorti Liman Spahiu, lindur në Burrel dhe banues në Tiranë.

Në vitin 1995 bashkëshorti im është larguar nga shtëpia dhe që prej atij viti nuk kemi asnjë të dhënë për fatin e tij, prandaj kërkoj të shpallet i zhdukur.

KËRKUESE
Luiza Rula

Fletorja Zyrtare gjendet:

- Në çdo njësi postare të çdo qyteti;
- Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare:
Rr.Qemal Stafa, pranë ndërtesës së Prokurorisë së Përgjithshme.

U dorëzua për shtyp më 21. 6. 2002
Doli nga shtypi më 22. 6. 2002

Tirazhi: 4250 copë	Formati: 60x88/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2002

Çmimi: 150 lekë